



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA ZA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Adresa Org. Org. kod Org. un.	Adresa Org. Org. kod Org. un.
11/29	230/24
Prishtinë / a	04.12.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i
transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIM ME ARTIKUJ USHQIMOR

LOT 5 - FURNIZIM ME ARTIKUJ TË NDRYSHËM USHQIMOR

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-24-8838-1-1-1

NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-24-8838-1-1-1/C626

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
Dhe

" Dauti Komerc SH.P.K., Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshe ushqimor

me numër identifikues: UA/2016-24-8838-1-1-1/C626

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Furnizim me artikuj të ndryshe ushqimor

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

Gjatë implementimit të kontratës mund të shtohen autoritete tjera nëse do të formohen gjatë kësaj kohe apo nëse ju lind nevoja për këto produkte apo nëse kanë arsyetim tjera objektiv për mungesën e tyre në Aneksin 7, në këto raste AQP do ju mundësoj shfrytëzimin e kontratës pas kërkesës së tyre dhe vlerësimit nga AQP-ja.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porositve" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoritetet Kontraktues të përmendur në Nenin 1.1 janë të detyruar të përdorin këtë kontratë kornizë sa herë që të blejnë mallëra të përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 01.09.2025 dhe përfundon në datën 31.08.2026. Kontrata mund të hyjë në fuqi edhe para kësaj date nëse kontrata aktuale përfundon më herët se afati i fundit për arsye të shpenzimit të sasive apo arsye tjera. Nëse do të shfaqet nevoja për hyrje të kësaj kontrate në fuqi para datës 01.09.2025 ajo do të behet me një njoftim paraprak nga AQP drejtuar kontraktuesit 5 ditë përpara, me këtë rast kontraktuesi është i obliguar të dorëzojë sigurimin e ekzekutimit të harmonizuar me data dhe të fillojë implementimin e kontratës. Në çdo situatë kontrata do të ketë validitet 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi, njoftimi për datat e validitetit të kontratës në këtë rast do të bashkëngjitet kontratës në faqen e fundit dhe do të mbizotërojë.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Vendi i përcaktuar nga Autoritetet kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **1,047,900.80 €** . Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është +/-30%.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME
- (e) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (f) Oferta financiare (Lista e Çmimeve) - ku përfshihen edhe specifikat e produktit;
- (g) Aneksi 7 LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE/NJESIVE KËRKUESE

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet



6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Emine Masurica	Emri:	Behxhet Rruqiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04/12/2024	Data:	04/12/2024
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Ertañ Bedri
Pozita:	Menzher
Nënshkrimi:	
Data:	04/12/2024
Vula:	